



**I/E NDERUAR
KANDIDAT/E,
NE JEMI
KUNDËR
GJAKMARRJES
... PO TI?**





Çdo vit Operazione Colomba organizon fushata kombëtare sensibilizimi me qëllim bashkimin dhe kanalizimin e përpjekjeve nga ana e shoqërisë civile dhe e institucioneve kombëtare në luftën kundër fenomenit i “hakmarrjes” dhe “gjakmarrjes”. Këtë vit, me rastin e Zgjedhjeve Lokale, Operazione Colomba ka vendosur t’u drejtojë të gjithë kandidatëve të të

gjitha partive në mbarë Shqipërinë disa pyetje në lidhje me fenomenin e “hakmarrjes” dhe të “gjakmarrjes” në mënyrë që të nxisë te përfaqësuesit e ardhshëm të popullatës civile një angazhim konkret për çrrënjosjen e kësaj praktike, siç është shprehur prej pjesës më të madhe të popullit shqiptar në nismat “5000 Firma për jetën” e vitit 2013 dhe “Një popull lëviz për paqen kundër gjakmarrjes” e vitit 2014 .

Nëpërmjet këtyre pyetjeve çdo kandidat/e do të ketë mundësi t’i tregojë Shoqërisë Civile interesin e tij/e saj aktiv për t’iu kundërvënë këtij fenomeni që, në disa zona të Shqipërisë, është motiv vdekjeje, dhimbjeje, dhune, frike dhe rreziku për qytetarët për të cilët kandidon.

Për këtë, vullnetarët e Operazione Colomba-s kanë organizuar fushatën e këtij viti duke i dërguar, me postë, të gjithë kandidatëve disa letra të Shoqatës sonë, që përmbajnë shpjegimin i nismës dhe pyetjet mbi këtë fenomenin. Po ashtu, vullnetarët kanë organizuar mbledhjen e përgjigjeve nëpërmjet një interviste të regjistruar në disa zona ku fenomeni i “hakmarrjes” dhe “gjakmarrjes” është më i shpërndarë.

Prandaj vullnetarët janë në pritje të përgjigjeve të kandidatëve me postë ose me mail.

Të gjitha përgjigjet, që pak nga pak vullnetarët do të marrin nga kandidatët, do të publikohen në platformë *on-line*:

<http://www.operazionecolomba.it/njepopullkundergjakmarrje>

Sot ju ftojme të lëni një këshill ne tavolinën përball Hotel Colosseo-s për të treguar të gjithë kandidatëve si mund të kundërshtojnë fenomenin i “hakmarrjes” dhe “gjakmarrjes”. Mesazhet tuaj do të publikohen në platformë *on-line*. **NA NDIQNI !!!**



Operazione Colomba
Corpo Nonviolento di Pace
Korpus Jo i Dhunshëm i Paqes